

## Vendim nr. 8 datë 15.01.2025

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj,	Kryetare
Sonila Bejtja,	Anëtare
Genti Ibrahimimi,	Anëtar

në datën 15.01.2025 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 11 (B) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

**KËRKUES:** BASHKIM SEFERI

**OBJEKTI:** Shfuqizimi i vendimeve nr. 535, datë 17.11.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës; nr. 00–2024–772, datë 25.04.2024 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 18, pika 2, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Genti Ibrahimimi, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

### V Ë R E N:

#### I

#### Rrethanat e çështjes

1. Në datën 26.04.2022 kërkuesi Bashkim Seferi i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës me kërkesë për rivendosjen në afat të së drejtës së ankimit kundër vendimit nr. (11-2016-5242) 535, datë 17.11.2016 të po asaj gjykate, bazuar në nenin 420/1 të Kodit të Procedurës Penale (*KPP*), sipas të cilit nuk është pranuar ankimi i bërë nga kërkuesi ndaj

vendimit të mosfillimit të procedimit penal nr. 1573 të vitit 2015 të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës.

2. Në datën 30.11.2016 vendimi nr. (11-2016-5242) 535, datë 17.11.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës ka marrë formë të prerë, për shkak se nuk është ankimuar nga palët ndërgjyqëse në proces. Në kërkesën për rivendosjen në afat të së drejtës së ankimit kërkuesi ka pretenduar se pas dhënies së vendimit ai është paraqitur në sportelin e sekretarisë së gjykatës për të tërhequr kopjen e vendimit për efekt ankimi, por nuk i është vënë në dispozicion, pasi nuk ishte zbardhur nga gjyqtari. Më pas, ai e ka pasur të pamundur të ushtrojë të drejtën e ankimit ndaj vendimit nr. 535, datë 17.11.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, për shkak të arsyeve shëndetësore të djalit të tij.

3. Me vendimin nr. (11-2023-1442) 50/212, datë 23.03.2023, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës ka vendosur rrëzimin e kërkesës së kërkuesit, si të pabazuar në prova dhe në ligj, duke arsyetuar se kërkuesi rezulton se ka pasur dijeni për vendimin penal të dhënë ndaj tij, dhe pa ndonjë shkak të arsyeshëm nuk ka bërë ankim, duke lënë që të kalojnë 7 vjet nga momenti i shpalljes së vendimit. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim kërkuesi.

4. Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, me vendimin nr. 1750/30-2023-6267, datë 06.11.2023, bazuar në nenin 420/1, shkronja “c”, të KPP-së, ka vendosur mospranimin e ankimit të kërkuesit, për shkak se ankimi nuk plotëson parakushtet për shqyrtimin e bazueshmërisë së tij. Kundër këtij vendimi kërkuesi ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë, duke kërkuar prishjen e vendimeve të gjykatave të faktit dhe pranimin e kërkesës për rivendosje në afat.

5. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00–2024–772, datë 25.04.2024, ka vendosur mospranimin e rekursit, duke vlerësuar se nuk i plotëson kushtet formale, për shkak të mosnënshkrimit të tij nga mbrojtësi, si dhe nuk përmban asnjë prej shkaqeve të parashikuara në nenin 432 të KPP-së.

6. Në datën 07.10.2024 kërkuesi ka paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatën Kushtetuese (*Gjykata*), sipas objektit, i cili, pasi është plotësuar me dokumentet e kërkuara, bazuar në nenin 27 të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 23.10.2024.

## II

### Pretendimet e kërkuesit

7. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës është marrë në shkleje të rënda ligjore dhe kushtetuese që konsistojnë në diskriminimin shoqëror që passjell probleme sociale familjare. Kërkuesit

duhet që t'i rikthehet e drejta e pagesës së invaliditetit të djalit të tij, pasi nuk ka përfituar pagesën e invaliditetit dhe perkujdesjes së djalit të tij edhe pse i ka plotësuar të gjitha kushtet e përfitimit.

### III

#### Vlerësimi i Kolegjit

##### A. Për legjitimimin e kërkuarit

8. Çështja e legjitimitit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Kriteret paraprake të pranueshmërisë së kërkesës janë kumulative, në kuptimin që mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuari të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjyqimit kushtetues.

9. Kërkuari, si bartës i të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara në Kushtetutë, legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor në të cilin janë dhënë vendimet e kundërshtuara, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

10. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, kërkuari i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm dhe pasi ka shteruar në formë e substancë mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta.

11. Për sa i përket legjitimitit *ratione temporis*, neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000 ka parashikuar afatin ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual. Vendimi më i fundit që ka përmbyllur procesin e kundërshtuar nga kërkuari është ai i Gjykatës së Lartë, i cili mban datën 25.04.2024, kurse ankimi kushtetues individual është paraqitur në Gjykatë në datën 20.09.2024. Sipas informacionit të marrë nga Gjykata e Lartë për këtë qëllim, evidentohet se vendimi nr. 00 – 2024 – 772, datë 25.04.2024

është publikuar në faqen zyrtare të kësaj gjykate në datën 27.06.2024, për rrjedhojë Kolegji vlerëson se kërkesa është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor.

12. Në lidhje me kriterin e legjitimitetit *ratione materiae*, Kolegji vëren se kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual, duke kundërshtuar formalisht vendimet gjyqësore të dhëna në procesin gjyqësor të vënë prej tij në lëvizje, me objekt rivendosjen në afat të së drejtës së ankimit ndaj vendimit nr. (11-2016-5242) 535, datë 17.11.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, që ka të bëjë me mospranimin e ankimit të tij ndaj vendimit të mosfillimit të procedimit penal nr. 1573 të vitit 2015 të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës. Sipas kërkuetit, ai është paraqitur në sportelin e sekretarisë së gjykatës për të tërhequr kopjen e vendimit për efekt ankimi, por nuk i është vënë në dispozicion, pasi nuk ishte zbardhur nga gjyqtari. Më pas, ai e ka pasur të pamundur të ushtrojë të drejtën e ankimit ndaj këtij vendimi për shkak të arsyeve shëndetësore të djalit të tij.

13. Në lidhje me këtë proces, Kolegji vëren se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr. (11-2023-1442) 50/212, datë 23.03.2023, ka argumentuar se kërkuesi nuk plotëson asnjë nga kushtet e parashikuara nga neni 420/1 i KPP-së dhe kërkesa e tij për rivendosje në afat të së drejtës për të bërë ankim është e pabazuar në ligj dhe në prova dhe si e tillë duhet refuzuar. Sipas gjykatës, palët duhet të tregohen korrekte në respektimin e afateve të parashikuara në legjislacionin procedural penal. Aq më tepër kjo kur pala ka pasur dijeni se vendimi do të ishte gati, pasi ka pyetur herë pas here në sportelin e gjykatës, si dhe ka kërkuar të ketë një përfaqësues falas në mënyrë që të kishte më të lehtë kërkimin e së drejtës. Ky vendim është lënë në fuqi nga gjykata e apelit, e cila ka vlerësuar se ankimi nuk është paraqitur në formën e kërkuar nga ligji. Në rastin në gjykim, gjykata e apelit vëren se ankimi është paraqitur nga vetë kërkuesi, i përpiluar me shkrim dhe dorëshkrim, ku ai ka parashtruar vullnetin për ankimimin e vendimit. Po ashtu, ajo vëren se kërkuetit i është ofruar ndihma juridike falas në gjykimin në shkallë të parë dhe ankimi nuk rezulton të jetë përpiluar apo nënshkruar nga avokati, por vetëm nga ana e tij. Duke qenë në kushtet që ankimi nuk ka respektuar dispozitat për formën, Gjykata e Apelit ka vendosur mospranimin e ankimit të kërkuetit, për shkak se ankimi nuk plotëson kushtet formale për shqyrtimin e bazueshmërisë së tij. Ndërsa Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 00–2024–772, datë 25.04.2024, ka vendosur mospranimin e rekursit, me argumentin se nuk plotëson kushtet formale, për shkak të mosnënshkrimit të tij nga mbrojtësi, si dhe nuk përmban asnjë prej shkaqeve të parashikuara në nenin 432 të KPP-së. Sipas Kolegjit Penal, shqyrtimi paraprak i kushteve formale për pranueshmërinë e rekursit është parësor dhe vetëm nëse rekursi i plotëson këto kushte, sipas nenit 435 të KPP-së, do të duhet të vijohet me shqyrtimin e tij në themel, të cilat në rastin konkret nuk plotësohen për

shkak të mungesës së nënshkrimit të rekursit nga mbrojtësi. Edhe për sa i përket themelit të pretendimeve të paraqitura në recurs, ky Kolegj ka vlerësuar se ato nuk janë të bazuara në ligj dhe si të tilla nuk përbëjnë shkak për cenimin e vendimit të gjykatës së apelit, e cila ka vendosur mospranimin e ankimit, sepse ky i fundit nuk përmbante shkaqe, pra nuk ishte paraqitur në formën e kërkuar nga ligji. Në mënyrë të njëjtë kërkuuesi ka vepruar edhe me paraqitjen e rekursit në Gjykatën e Lartë, pasi e ka paraqitur atë të panënshkruar nga mbrojtësi.

14. Gjykata në jurisprudencën e saj ka pohuar se detyra e saj është të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrар, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës. Ajo nuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt dhe për këtë arsye vendimet e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm nuk vihen në dyshim, përveç rasteve kur gjetjet e tyre mund të konsiderohen si arbitrare ose haptazi të paarsyeshme. Thënë ndryshe, Gjykata vepron në rastin kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e arsyeshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose i tillë që gjykimin e bën të padrejtë (*shih vendimin nr. 30, datë 29.05.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Për sa më sipër, në rastin konkret, Kolegji konstaton se gjatë procesit gjyqësor të kundërshtuar nga kërkuuesi nuk konstatohen shkelje të të drejtave kushtetuese dhe as që zbatimi i ligjit nga gjykatat të ketë qenë arbitrар, pra që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë sipas nenit 42 të Kushtetutës. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkuuesit për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor është haptazi i pabazuar.

16. Në përfundim, Kolegji vlerëson se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Kolegji i Gjykatës, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

### **V E N D O S I:**

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.